



Shkolla Pas Fillores

(dytësore e gradës së parë)

Shkolla pas fillores (dytësore e gradës së parë) zgjat tre vjet dhe përbëhet në fillim nga një dyvjeçar dhe pastaj në një vit të tretë të orientimit dhe lidhjes me ciklin e dytë të mësimimit.

Shkollën dytësore të gradës së parë e frekuentojnë nxënësit e moshës nga 11 deri në 14 vjeç.

Rregjistrimi dhe frekuentimi janë falas ndërsa shpenzimet për blerjen e librave të teksteve janë në ngarkim të familjeve. Duhet të blihen nga nxënësi edhe gjërat e tjera që shërbejnë për shkollë (fletore, pena, ngjyra, etj.).

Keni mundësi që të merrni një kontribut në para nën formën e çekut o të bursave të studimit për të blerë librat ndihmës mësimorë, për aktivitete mësimore, udhëtime mësimore dhe lehtësime në pagesën e shërbimit të transportit dhe të mensës. Është e nevojshme të plotësoni kërkesën që shpërndahet nga Komuna ose shkollat dhe formularin ISEE për çertifikimin e të ardhurave.

Nxënësit me vështirësi ekonomike mund të marrin hua librat për vitin shkollor.

Pyetni në sekretari nëse keni mundësi të merrni hua.

*** RREGJISTRIMI**

Për të rregjistruar fëmijën në shkollë prindi duhet të plotësojë formularin e dhënë nga sekretaria . Duhet të autoçertifikojë në të datën e lindjes së nxënësit si dhe gjithë informacionet e kërkuara (sillni me vete pasaportën ose lejen e qëndrimit).

Janë të nevojshme dokumentat e mëposhtëm:

- ✓ **Dokumenti i identitetit të fëmijës** (Në mungesë të këtyre dokumentave sillni me vete një dokument identiteti tuajin)
- ✓ **Dokumentat e shkollës së frekuentuar** (Në mungesë të këtyre dokumentave prindi deklaron nën përgjegjësinë e tij, klasën e frekuentuar në vendin e lindjes)

Në momentin e rregjistrimit plotësohen formularët për:

- ✓ Zgjedhjen e tipit të shkollës
- ✓ Nëse duan të përfitojnë ose jo nga mësimi i fesë katolike
- ✓ *Rregjistrimi në sallën e ngrënies së shkollës/mensë*

Për shpërndarjen dhe plotësimin e formularëve të mensës, në disa raste merret direkt shkolla, në të tjera duhet t'i drejtoheni Enteve lokale: Bashkia, Komuniteti i zonave malore....



* ORARI

Në shumë shkolla prindërit mund të zgjedhin ndërmjet dy mundësive të orarit dhe organizimit shkollor:

✓ shkolla me “kohë normale - tempo normale”:

është me 30 orë javore nga e hëna deri të shtunën nga 8.15 deri 13.15 ose nga e hëna deri të premten me disa hyrje pasdite.

✓ shkolla me “kohë të zgjatur - tempo prolungato”:

parashikon kohën që i dedikohet mensës dhe hyrjet pasdite. Çdo shkollë organizon orarin mbi 5 o 6 ditë dhe në mënyrë të ndryshme.

Në shumë shkolla tetëvjeðare organizohen aktivitete sportive (volejball, basketboll) o të tipeve të tjera (teatër, gjuha latine etj.) me çmime të ulëta.

Është e rëndësishme të jeni të përpiktë

Informohuni direkt mbi oraret e klasës së fëmijës suaj dhe aktivitetet që organizohen

* KALENDARI SHKOLLOR

Shkolla zgjat rreth 9 muaj. Fillon në mes të shtatorit dhe mbaron në mes të qershorit.

Ka dy periudha pushimesh: dy javë për Krishtlindje (zakonisht nga 23 dhjetori deri me 6 janar)

Rreth një javë për Pashkë (në mars o prill).

Pastaj janë disa ditë pushimesh të ndara gjatë vitit.

Shkolla do t’ju informojë çdo herë me një lajmërim të shkruar në ditarin e fëmijës ose me një kalendar vjetor ku shënohen mbylljet për festa.

Prindërit do të njoftohen edhe për grevat o ndërprerje të tjera të mundshme të mësimt.

Është e rëndësishme të kontrolloni gjithmonë ditarin!

* MUNGESA NGA SHKOLLA

Çdo mungesë duhet të justifikohet gjithmonë nga prindërit në librezën e mungesave ose në ditar. Nxënësi duhet të paraqesë një justifikim të firmosur nga prindërit edhe kur hyn me vonesë në shkollë ose kur duhet të dalë përpara.



* ÇFARË MËSOJNË FËMIJËT NË SHKOLLË

Për sa i përket shkollës dytësore të gradës së1°(tetëvjeçare), lëndët janë: italisht, anglisht, gjuhë e dytë komunitare (në krahinën e Cuneo-s është Frëngjishtja), histori, gjeografi, matematikë, shkenca dhe teknologji, informatikë, muzikë, arte dhe vizatim, fiskulturë, feja katolike (fakoltative).

* PËR TË MËSUAR ITALISHTEN

Për të ndihmuar fëmijën tuaj që të ambientohet në klasë dhe për t'i mësuar gjuhën e re , mësuesit do të organizojnë momente të posaçme për të dhe aktivitete për mësimin e italishtes së shkruar dhe të folur.

* MËSIMI I FESË KATOLIKE O ZGJEDHJE ALTERNATIVE

Në shkollën italiane parashikohet mësimi fakultativ i fesë katolike. Në momentin e rregjistrimit prindi mund të zgjedhë:

- ✓ Të përfitojë ose jo nga mësimi i fesë katolike
- ✓ Aktivitete didaktike dhe përgatitore në grup
- ✓ Aktivitete studimi ose kërkimi individual me ndihmën e një mësuesi
- ✓ Dalje nga shkolla

* SI VERËSOHEN REZULTATET SHKOLLORE

Çdo vit shkollor ndahet në dy pjesë (2 katërmujorë). Nga shtatori në janar dhe nga shkurti në qershor. Në janar dhe qershor mësuesit bëjnë një vlerësim të rezultateve shkollore të fëmijës dhe përgatisin një "skedë vlerësimi - dëftesë" që do t'i dorëzohet familjes .

Gjatë katërmujorit bëhen detyra kontrolli në klasë që shërbejnë për të dhënë vlerësimin e katërmujorit të parë dhe të dytë

* MBLEDHJET NDËRMJET PRINDËRVE DHE MËSUESVE

Gjatë vitit shkollor organizohen disa mbledhje klase ndërmjet prindërve dhe mësuesve. Këto janë raste shumë të rëndësishme për të folur së bashku dhe për të njohur më mirë programin e studimit . Prindërit dhe mësuesit mund të bashkëpunojnë për edukimin e fëmijëve dhe hyrjen e tyre në shoqëri.

Çdo klasë në fillim të vitit zgjedh një përfaqësues të prindërve me anë të votimit.



* BASHKËBISEDIME

Mësuesit në mënyrë periodike takojnë prindërit për të folur me ta mbi programin e klasës, mbi fëmijët, mbi vështirësitë dhe përparimin e tyre.

Çdo mësues njofton prindërit mbi ditën në të cilën mund t'i takojë për të folur.

Edhe prindërit mund të kërkojnë një bashkëbisedim me mësuesit; nëse kanë vështirësi me gjuhën mund të jetë prezent një mediator kultural

Nëse doni të flisni mbi fëmijën tuaj ,kërkoni menjëherë një takim me mësuesin/en

* MENSA (DREKA NË SHKOLLË)

Shërbimi i mensës është gati në të gjithë shkollat. Prindërit paguajnë për drekën një çmim që bazohet mbi të ardhurat familjare.

Është e mundur të kërkonit një dietë të veçantë , kërkesen duhet t'ja dorëzoni përgjegjësit të mensës per:

- ✓ motive shëndeti (është e nevojshme letra e mjekut)
- ✓ motive feje (është e nevojshme deklarata e prindërve)

Njoftoni në raste alergjije ose jo tolerime.

Për regjistrimin për ngrënien në shkollë duhet të plotësoni formularin e shtypur që ju dorëzohet nga Sekretarija e Bashkisë ose nga shkolla.

Për pyetje të mundshme o për çfarëdo problemi drejtohuni tek sekretarija e shkollës.